



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës      Opština Podujevo      Municipality of Podujeva



## **KRYETARI I KOMUNËS**

Bazuar në nenet 13, 17 shkronja h) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 35.5 të Ligjit nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikës e Kosovës, nenin 18 paragrafët 1, 2.2 dhe 3 të Rregullores ( QRK) Nr. 19/2024 Për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instrukturëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo – Arsimore dhe Aftësuese ( IEAA) të Arsimit Parauniversitar si dhe nenet 16, 19 parag. 1.8 dhe 61 parag.1.3 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, në propozim të Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit, nr. prot. 02-112/02-0011863/26, datë 26.02. 2026, merr;

### **VENDIM PËR EMËRIMIN E PËRKOHSHËM NË POZITËN E DREJTORIT TË IAAP “ISA BOLETINI” NË PODUJEVË**

#### **Neni 1**

**z.Bedri Mustafa**, nga fshati Gllamnik, Komuna e Podujevës, me nr.personal të letërnjoftimit me kualifikim Baçelor i Edukatës së Punës me Informatikë,

**Emërohet përkohësisht në pozitën e Drejtorit të IAAP “Isa Boletini”, në Podujevë.**

#### **Neni 2**

I përmenduri sipas nenit 1 të këtij vendimi emërohet përkohësisht deri në zgjedhjen/emërimin e Drejtorit/eshës sipas procedurës së rregullt të konkursit apo deri në një akt tjetër administrativ.

#### **Neni 3**

Kushtet e punës, të drejtat, përgjegjësitë dhe paga mujore caktohen me kontratën e punës.

#### **Neni 4**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

#### **Neni 5**

Zbatimin e vendimit dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me këtë vendim e bën Drejtoria e Arsimit.

*U dërgohet:  
Drejtorisë së Arsimit  
Të emëruarit  
QSHQ/Arkivit*

**Nr. prot.** 02-112/02-0011863/26  
**Podujevë, datë:** 03.03.2026





## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 17 shkronja h) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 35.5 të Ligjit nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikës e Kosovës, nenin 18 paragrafët 1, 2.2 dhe 3 të Rregullores (QRK) Nr. 19/2024 Për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instrukturëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo – Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar si dhe nenet 16, 19 parag. 1.8 dhe 61 parag.1.3 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, në propozim të Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit, nr. prot. 02-112/02-0011863/26, datë 26.02. 2026, merr;

### VENDIM PËR EMËRIMIN E PËRKOHSHËM NË POZITËN E ZËVENDËSDREJTORIT TË IAAP “ISA BOLETINI” NË PODUJEVË

#### Neni 1

**z.Alban Mahmuti**, nga fshati Dobratin, Komuna e Podujevës, me nr.personal të letërnjoftimit me kualifikim Baçelor për Banka, Financa dhe Kontabilitet,

**Emërohet përkohësisht në pozitën e Zëvendësdrejtorit të IAAP “Isa Boletini”, në Podujevë.**

#### Neni 2

I përmenduri sipas nenit 1 të këtij vendimi emërohet përkohësisht deri në zgjedhjen/emërimin e Drejtorit/eshës sipas procedurës së rregullt të konkursit apo deri në një akt tjetër administrativ.

#### Neni 3

Kushtet e punës, të drejtat, përgjegjësitë dhe paga mujore caktohen me kontratën e punës.

#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

#### Neni 5

Zbatimin e vendimit dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me këtë vendim e bën Drejtoria e Arsimit.

U dërgohet:  
Drejtorisë së Arsimit  
Të emëruarit  
QSHQ/Arkivit

Nr. prot. 02-112/02-0012741/26  
Podujevë, datë: 03.03.2026





## KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja c të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 24 të Rregullores (QRK) - Nr. 01/2018 Për Kthimin e Personave të Zhvendosur dhe Zgjidhje të Qëndrueshme dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.3 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/1, merr:

### V E N D I M PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL PËR KTHIM

#### Neni 1

Themelohet Komisioni Komunal për kthim në këtë përbërje:

- |   |          |
|---|----------|
| 1.Liman Zeqiri Shef i Zyrës për Komitete dhe Kthim ZKKK,                    | Kryesues |
| 2.Selman Gashi, Drejtoria e Arsimit,  | anëtar   |
| 3.Arbresha Bashota, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale         | anëtare  |
| 4.Ormirë Dibrani, Qendra Për Punë Sociale –QPS,                             | anëtare  |
| 5.Naime Ajeti, Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtje dhe Shpëtim,         | anëtare  |
| 6.Musli Kutleshi, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, | anëtar   |
| 7.Florie Humolli, Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë,              | anëtare  |
| 8. _____, përfaqësues nga Ministria Për Komunitete dhe Kthim,               | anëtar   |

#### Neni 2

Komisioni detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në përputhje me Ligjin nr.03/L-047 Për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtareve të Tyre në Republikën e Kosovës si dhe Rregullores (QRK) - Nr. 01/2018 Për Kthimin e Personave të Zhvendosur dhe Zgjidhje të Qëndrueshme.

#### Neni 3

Mandati i anëtarëve të Komisionit Komunal është tri vite me mundësi vazhdimi edhe për një mandat shtesë.

#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:

Anëtarëve të Komisionit

Ministrisë Për Komunitete dhe Kthim

QSHQ/Arkivit

Nr.prot. 02-020/04-0013598/26  
Podujevë, datë, 06-03-2026

Kryetari i Komunës  
Shpejtim Bulliqi





**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenit 14 të Ligjit nr.08/L-103 për sistemin e menaxhimit të performancës së Komunave dhe skemën e grantit të bazuar në performancë, Udhëzim Administrativ (MAPL) nr.01/2023 për menaxhimin e performancës komunale dhe skemën e grantit për performancë komunale, dhe neneve 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kryetari i Komunës nxjerrë këtë;

### **V E N D I M**

#### **PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E VENDIMIT Nr.Prot.02-020/04-0008688/25**

##### **Neni 1**

Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet Vendimi nr.prot.02-020/04-0008688/25 i datës 06.02.2025 për caktimin e koordinatorit për performancë si dhe zyrtarëve raportues për fushat e performancës në Komunën e Podujevës, dhe atë:

**z.Omer Kosumi**, zyrtar për rini, në Drejtorinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit, caktohet anëtar i Komisionit në fjalë, *Fusha 5-Kulturë Rini dhe Sport*, në vend të ish anëtarit z.Arbër Sfishta i cili ka kaluar në punë dhe detyra tjera të punës në një institucion tjetër.

##### **Neni 2**

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe i njëjti është pjesë përbërëse e Vendimit bazë nr.prot.02-020/04-0008688/25 të datës 06.02.2025, me ndryshim plotësimin sipas Vendimit nr.prot.02-020/04-0004240/26 d të datës 20.01.2026.

*U dërgohet;*  
*Të emëruarit dhe anëtarëve (përmes koordinatorit)*  
*QSHQ / Arkivës*

Nr.Prot. 02-020/04-0013594/26  
Podujevë, datë: 06.03.2026

**Kryetari i Komunës**  
**Shpejtim Bulliqi**





**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## **KRYETARI I KOMUNËS**

Bazuar në nenin 58 shkronjat b) dhe i) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafët 1.2 dhe 1.9, të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafët 3.1 dhe 3.2 të Rregullores Komunale për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot. 01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të datës 10.03.2026 të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0014132/25 datë 07.03.2025, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, merr;

### **VENDIM PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PERSONAVE ME GJENDJE TË RËNDË SHËNDETËSORE DHE SOCIALE**

#### **Neni 1**

Me këtë vendim lejohet dhënia e ndihmës financiare në shumë të përgjithshme prej katërmëdhjetëmijë euro (14000 €) ndihmë për shtatëdhjeteshtatë (77) persona me gjendje të rëndë shëndetësore dhe ekonomike - sociale për muajin shkurt 2026, sipas shumave individuale të paraqitura në listën e rekomanduar nga komisioni përkatës.

#### **Neni 2**

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

#### **Neni 3**

Shuma e mjeteve individuale sipas listës bashkangjitur këtij vendimi nuk tejkalon shumën e mjeteve financiare sipas Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022.

#### **Neni 4**

Lista e përfituesve të ndihmës financiare është pjesë përbërëse e Vendimit.

#### **Neni 5**

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

#### **Neni 6**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot 02-400/03-0014307/26  
Podujevë, datë 11.03.2026

**Kryetari i Komunës  
Shpejtim Bulliqi**



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Bazuar në nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenet 16 dhe 61 parag.1.2 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, në pajtim me nenin 12 të Rregullores MF – Nr. – 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, në kërkesë të Drejtoreshës së Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit datë 16.03.2026, nxjerr:

### **VENDIM**

#### **PËR SHPALLJEN E THIRRJES PUBLIKE PËR MBËSHTETJE FINANCIARE PUBLIKE OJQ-të NË KOMUNËN E PODUJEVËS NË FUSHËN E AKTIVITETEVE KULTURORE DHE RINORE**

##### **Neni 1**

- 1.Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e Rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
- 2.Mbështetja financiare publike e OJQ - ve në Komunën e Podujevës, në fushën e aktiviteteve kulturore dhe rinore ofrohet nga Buxheti i Komunës së Podujevës, kodi ekonomik 21200, në kuadër të programit/nënprogramit 85005.

##### **Neni 2**

Mjetet financiare shpërndahen në bazë të thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve- Klubeve sportive sipas vlerësimit dhe përzgjedhjes nga ana e komisionit si dhe dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

##### **Neni 3**

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II të këtij vendimi përfshinë:
  - 1.1. Teksti i thirrjes publike
  - 1.2. Udhëzimet për aplikantët
  - 1.3. Formularët e aplikimit
2. Formularët e aplikimit referuar në paragrafin 1 të këtij neni janë:
  - 2.1. Forma e përshkrimit të programit apo projektit
  - 2.2. Forma e buxhetit të programit apo projektit
  - 2.3. Forma e deklaramit të mungesës së fondeve të dyfishta
  - 2.4. Deklarata e Partneritetit

#### **Neni 4**

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të Komunës së Podujevës <https://kk.rks-gov.net/podujeve/>.

#### **Neni 5**

1. Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, do të formohet Komisioni Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.

2. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.

3. Komisioni Vlerësues punët dhe detyrat do t'i ushtrojnë në përputhje me rregullat e parapara me Rregulloren për financimin publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

#### **Neni 6**

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

#### **Neni 7**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot. 02-400/03-0015455/26  
Podujevë, datë: 17. 03. 2026





**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## **KRYETARI I KOMUNËS**

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neneve 7 dhe 9 të Rregullores MF-NR-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 16 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, sipas kërkesës së znj. Lindita Ymeri, Menaxhere për Zhvillimin e kapaciteteve në Asociacionin e Komunave të Kosovës-AKK, për themelimin e Grupit të përfaqësuesve nga komuna, merr:

### **V E N D I M** **PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT NR. 02-020/05-0004244/26** **DATË 20.01.2026**

#### **Neni 1**

Ndryshohet dhe plotësohet përbërja e Grupit të përfaqësuesve nga Komuna e Podujevës, sipas Vendimit 02-020/05-0004244/26, datë 20.01.2026, për zbatimin e aktiviteteve të parapara me projektin ReLOaD3, dhe atë :

Në vend të **Rilind Babatinca**, në cilësinë e anëtares së Grupit caktohet **Donjetë Potera**, zyrtare për koordinimin e investimeve të diasporës, Email; [donjete.potera@rks-gov.net](mailto:donjete.potera@rks-gov.net)  
tel: +383. [REDACTED]

#### **Neni 2**

Vendimi është pjesë përbërëse e Vendimit bazë nr. 02-020/05-0004244/26, datë 20.01.2026.

#### **Neni 3**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:*  
*Të caktuarës*  
*znj. Lindita Ymeri-AKK*  
*QSHQ/Arkivës*

**Nr.prot.** 02-020/05-0016414/26  
**Podujevë, datë:** 23.03.2026





**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 8 të Rregullores MF - Nr – 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenin 16 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, duke përfshirë dy përfaqësues të shoqërisë civile, në cilësinë e anëtarëve të këtij komisioni, të zgjedhur nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, përmes Njoftimit publik nr.prot. 06-550/01-0012131/26, datë 27.02.2026, merr:

### **V E N D I M**

#### **Neni 1**

Për shqyrtimin e aplikacioneve të OJQ-ve për mbështetje financiare për projekt/programet që kontribuojnë në zbatimin e programit të DSHMS-së, i cili u dedikohet personave me nevoja të veçanta sipas Thirrjes publike nr.prot.06-400/03-0011963/26, datë 26.02.2026, themelohet komisioni në përbërje:

**Selman Gashi**, kryesues, zyrtar për çështje pedagogjike - Drejtoria e Arsimit  
**Nafie Gërguri**, anëtare, asistente administrative - Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale  
**Haxhere Ajvazi**, anëtare, zyrtare e larte për buxhet dhe financa - Drejtoria e Buxhetit dhe Financave  
**Shqipdon Rushiti**, anëtar- Shoqëria civile  
**Vjollca Breznica**, anëtare-Shoqëria civile

**Naxhie Hasani**, zyrtare për invalid të luftës dhe familjeve të dëshmorëve-Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, caktohet anëtare rezervë, e cila zëvendëson anëtarin/en e Komisionit në rast të paraqitjes së konfliktit të interesit gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikacioneve.

#### **Neni 2**

Komisioni, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në përputhje me rregullat e parapara me Rregulloren për financimin publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

#### **Neni 3**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Anëtarëve të Komisionit

Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

QSHQ/Arkivit

**Nr.prot.** 02-02/04-0016411/26  
**Podujevë, datë;** 23. 03. 2026



**Kryetari i Komunës**  
**Shpejtim Bulliqi**



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Bazuar në nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenet 16 dhe 61 parag.1.2 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, në pajtim me nenin 12 të Rregullores MF – Nr. – 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, në kërkesë të Drejtoreshës së Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit datë 16.03.2026, nxjerr:

### **VENDIM PËR SHPALLJEN E THIRRJES PUBLIKE PËR MBËSHTETJE FINANCIARE PUBLIKE OJQ-KLUBET SPORTIVE NË KOMUNËN E PODUJEVËS NË FUSHËN E AKTIVITETEVE SPORTIVE**

#### **Neni 1**

- 1.Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e Rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
- 2.Mbështetja financiare publike e OJQ-ve/Klubeve sportive në Komunën e Podujevës, në fushën e aktiviteteve sportive ofrohet nga Buxheti i Komunës së Podujevës, kodi ekonomik 21200, në kuadër të programit/nënprogramit 85005.

#### **Neni 2**

Mjetet financiare shpërndahen në bazë të thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve-Klubeve sportive sipas vlerësimit dhe përzgjedhjes nga ana e komisionit si dhe dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

#### **Neni 3**

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II të këtij vendimi përfshinë:
  - 1.1. Teksti i thirrjes publike
  - 1.2. Udhëzimet për aplikantët
  - 1.3. Formularët e aplikimit
2. Formularët e aplikimit referuar në paragrafin 1 të këtij neni janë:
  - 2.1. Forma e përshkrimit të programit apo projektit
  - 2.2. Forma e buxhetit të programit apo projektit
  - 2.3. Forma e deklaramit të mungesës së fondeve të dyfishta
  - 2.4. Deklarata e Partneritetit

#### Neni 4

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të Komunës së Podujevës <https://kk.rks-gov.net/podujeve/>.

#### Neni 5

1. Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, do të formohet Komisioni Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.

2. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.

3. Komisioni Vlerësues punët dhe detyrat do t'i ushtrojnë në përputhje me rregullat e parapara me Rregulloren për financimin publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

#### Neni 6

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

#### Neni 7

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot. 02-400/03-0016554/26  
Podujevë, datë: 23.03.2026





**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## **KRYETARI I KOMUNËS**

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L- 040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 26 paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 dhe 3.2, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0014132/25 datë 07.03.2025, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot.02-400/04-0016936/26 të datës 24.03.2026, merr:

### **V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE**

#### **Neni 1**

**znj.Shukrije Mustafa**, nga fshati Gllamnik, Komuna e Podujevës për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve mjekësore dhe gjendjes së rënduar ekonomiko-sociale i jepet ndihmë financiare në shumë 300€.

#### **Neni 2**

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat barten përmes bankës në llogarinë e të përmendurës.

#### **Neni 3**

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

#### **Neni 4**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:*

*Drejtorive përkatëse.*


*QSHQ/Arkivit.*

*znj.Shukrije Mustafa (njoftohet përmes DSHMS-së).*

**Nr.prot** 02-400/04-0017622/26  
**Podujevë, datë,** 26.03.2026

**Kryetari i Komunës  
Shpejtim Bulliqi**





## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-02/01-0050862/18, nenet 3.3, 11.1 dhe 22 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, Vendimin nr.prot.01-400/01 - 0062888/25, të datës 29.09.2025, Për Miratimin e Projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2026 dhe Parashikimet Buxhetore 2027-2028, në implementimin e projektit "Furnizimi dhe montimi i serrave", në rekomandim të Komisionit Ad-Hoc të ngritur me vendimin nr.prot.02-020/04-0077381/25 të datës 27.11.2025, për shqyrtimin edhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve sipas Ftesës Publike nr.12-320/01-0071960/25, të datës 07.11.2025, Kryetari i Komunës, merr:

### V E N D I M

#### Neni 1

Lejohen mjete financiare për realizimin e projektit "Furnizimi dhe montimi i serrave", sipas ftesës publike nr.prot 12-320/01-0071960/25 të datës 07.11.2025, përkatësisht për 149 fermer përfitues, përmes formës së participimit në vlerë 324,862.90€ nga e cila 227,404.03€ apo 70% e vlerës financim nga Komuna e Podujevës dhe 97,458.87€ apo 30% e vlerës së participimit është financim nga ana e fermerëve përfitues sipas kategorive të serrave si në vijim;

- Serrë 50 m<sup>2</sup>, 134 fermer/e përfitues, vlera totale 154,515.40€ nga e cila 108,160.78€ apo 70% e vlerës financim nga Komuna e Podujevës dhe 46,354.62€ apo 30% e vlerës së participimit nga ana e fermerëve përfitues.

-Serrë500m<sup>2</sup>, 10 fermer/e përfitues vlera totale është 84,788.00€ nga e cila 59,1351.60€ apo 70% e vlerës financim nga Komuna e Podujevës dhe 25,436.40€ apo 30% e vlerës së participimit nga ana e fermerëve përfitues.

-Serrë 1000m<sup>2</sup>, 5 fermer/e përfitues vlera totale është 85,559.50€ nga e cila 59,891.65€ apo 70% e vlerës financim nga Komuna e Podujevës dhe 25,667.85€ apo 30% e vlerës së participimit nga ana e fermerëve përfitues.

#### Neni 2

Qëllim i realizimit të këtij projekti është promovimi dhe zhvillimi i bujqësisë në territorin e Komunës së Podujevës.

### Neni 3

Lista e aplikuesve të përzgjedhur për implementimin e projektit: "Furnizimi dhe montimi i serrave", sipas nenit 1 është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

### Neni 4

Për zbatimin e Vendimit kujdeset Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, i cili do të bëjë verifikimin, konstatimin dhe vlerësimin e përmbushjes së kushteve dhe kritereve nga ana e fermerit/es si dhe çështjeve tjera të parapara sipas ftesës publike përkatëse.

### Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. prot 02-400/03-0018735/26  
Podujevë, datë 30.03.2026





**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Bazuar në nenet 13 dhe 14.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenin 4.6 të Rregullores MF-nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore dhe nenet 16 dhe 17.1 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, nxjerr:

### **VENDIM**

#### **PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËR INVENTARIZIMIN E PASURISË JO FINANCIARE NË PRONËSI TË KOMUNËS SË PODUJEVËS**

##### **Neni 1**

Për inventarizimin e pasurisë jo financiare të Komunës së Podujevës, ngritet komisioni në këtë përbërje:

<b>Albana Haxha Berisha</b> - Drejtorja e Buxhetit dhe Financave,	<i>kryesuese</i>
<b>Jakup Gashi</b> - Drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit	<i>anëtar</i>
<b>Adem Ajvazi</b> - Drejtorja e Arsimit	<i>anëtar</i>
<b>Ramadan Plakolli</b> - Drejtorja e Administratës,	<i>anëtar</i>
<b>Naser Rama</b> , zyrtar në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare-QKMF	<i>anëtar</i>

Mandati i komisionit është dy (2) vite.

##### **Neni 2**

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë të përcaktuara me Rregullore MF-nr.03/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore.

##### **Neni 3**

Për punën e kryer Komisioni i paraqet raport Kryetarit të Komunës, përmes Drejtorit të Drejtorisë së Administratës.

##### **Neni 4**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, ndërsa shfuqizohet Vendimi nr. prot.02-020/04-0082156/25, datë: 24.12.2025.

**Nr.prot.02-020/04-0018549/26**  
**Podujevë, dt: 30.03.2026**

**Kryetari i Komunës**  
**Shpejtim Bulliqi**

